

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN NGA PËRPLASJA ME MJET TJETËR MOTORIK "MINI-KASKO"

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. "TERMA TË PËRGJITHSHËM"

a) "Siguruesi" nënkupton Albsig Sh.a që lëshon këtë kontratë në cilësinë e shoqërisë siguruese; **b)** "I Siguruari" nënkupton personin fizik ose juridik, interesi i të cilit mbrohet nga sigurimi; **c)** "Përfituesi" nënkupton personin fizik ose juridik të përcaktuar në Policën e Sigurimit si përfitues i dëmshpërblimit me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit; **d)** "Përdorues" nënkupton personat që përdorin mjetin motorik të siguruar, emrat e të cilëve janë të shënuar detyrimisht në kontratën e sigurimit dhe për të cilët është i vlefshëm mbulimi në rast sigurimi; **e)** "Kontrata" është lidhja e marrëveshjes midis Siguruesit dhe të Siguarit; **f)** "Kushtet e Sigurimit" nënkupton kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të kontratës për sigurimin Kasko të mjeteve motorike të pranura dhe nënshkruara nga palët; **g)** "Mjeti Motorik i Siguar" nënkupton mjetin e treguar në policën e sigurimit, për të cilën është përcaktuar rreziku, periudha e sigurimit dhe është paguar primi i sigurimit; **h)** "Dëmtim Aksidental" nënkupton një ngjarje të papritur e cila shkaktohet drejtpërdrejtë në mjetin motorik të siguruar vetëm si rezultat i përplasjes me një mjet tjetër motorik; **i)** "Mjet Motorik" sipas kësaj kontrate sigurimi nënkupton të gjitha mjetet motorike sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë;

Neni 2. "OBJEKTI (RREZIKU) I SIGURIMIT"

Objekti i sigurimit sipas këtyre kushteve është sigurimi i vetë mjetit motorik në lëvizje dhe nën drejtimin e të siguarit/perdoruesit

i përcaktuar si i tillë në kontratën e sigurimit/policën e sigurimit, nga thyerja e xhamave të mjetit ose fenerëve (stopave) që pëson nga përplasia e tij në rrugë me një mjet tjetër motorik i identifikuar, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ngjarje kjo e vërtetuar me raportin e policisë, foto të mjeteve të përfshira në vendngjarje si dhe me skicën përkatëse të vendit të ngjarjes. **Baza Ligjore:** Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.52/2014, "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" si dhe Kushtet e kësaj Kontrate Sigurimi.

Neni 3. "RREZIQET E SIGURUARA"

Siguruesi do të dëmshpërblejë të siguarin deri në limitin maksimal të përgjegjësisë (deri në shumën e sigurimit) sipas kësaj kontrate sigurimi, për dëmet në xhama ose fenerve e stopave të shkaktuara në mjetin motorik i cili rezulton i siguar nga: **a)** Dëmtimi aksidental i mjetit motorik në lëvizje vetëm me një mjet tjetër motorik të identifikuar. Rasti i sigurimit duhet të vërtetohet detyrimisht me raportin e policies, foto të mjeteve të përfshira në vendngjarje dhe të vendit të ngjarjes; **b)** Kjo kontratë sigurimi është e vlefshme vetëm për një rast sigurimi të ndodhur gjatë periudhës të vlefshmërisë të sigurimit;

Neni 4. "PËRJASHTIME NGA MBULIMI NË SIGURIM I MJETIT TË SIGURUAR"

Në rast dëmtimi aksidental të mjetit, Siguruesi nuk do të dëmshpërblejë të siguarin për: **a)** Dëmet Shëndetësore; **b)** Dëmet e shkaktuara qëllimisht nga personi i

Siguruar ose nga persona të paidentifikuar (si gërvishje, goditje, përmbysje, zjarrvënie, eksplozion, thyerje xhamash); **c)** Dëmet e pësuar në cdo pjesë të mjetit si pjesët e jashtme, motorrike, xhenerike, tapiceri, goma e disqe, përjashtuar (Xhamat, Fenerët ose stopat) të cilat përbëjnë ngjarje të siguruar; **d)** Dëmet që shkaktohen nga përdorues të mjetit të siguruar, emrat e të cilëve nuk janë shënuar në kontratën e sigurimit që (nënkupton janë të pasiguruar); **e)** Dëmet që rezultojnë nga çdo akt i luftës, veprimeve të armatosura pavarësisht në se është deklaruar lufta ose jo, lufta civile, turbullira civile, revolucione, lëvizje separatiste, kryengritje popullore, rebelimit, revolta, grushtë shteti, eksode, akteve terroriste, grevës, sabotimit; **f)** Dëmet që vijnë si rezultat i shpërthimit dhe rrezatimit bërthamor, ndotjes radioaktive, rrezatimeve jonizuese, ndotjeve kimike; **g)** Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi nga Organet e Shtetit; **h)** Dëmet që rezultojnë nga konsumi normal, defekte apo avaritë e brëndshme elektrike apo mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit; **i)** Prerja apo skopjimi i gomave, por dhe dëmet që pasojnë; **j)** Dëmet në mjetin motorrik të siguruar në operacione të tilla si: Shërbimi, Riparimi, Kontrolli, Larja, Parkimi, dorëzimi ose shitja; **k)** Dëmet e shkaktuara nga përdoruesit të pa pajisjur me dëshminë e aftësisë për drejtimin e mjetit dhe kur këta janë të shënuar në policën e sigurimit apo familjare të të siguruarit; **l)** Dëmet e shkaktuara si shkak i veprimeve të kryera me dashje ose të tentuara nga i Siguruarit, dhe/ose e gjendjes së drejtuesit të mjetit nën ndikimin e efektit të alkoolit, drogës apo narkotikëve të ndryshëm ose kur i Siguruarit refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli; **m)** Dëmet e shkaktuara në një mjet nga transportimi i lëndëve radioaktive, eksplozive, gërryese, ndezëse, jonizuese, etj;

n) Dëmet ose humbjet e objekteve, sende personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në mjet në momentin e rastit të sigurimit; **o)** Siguruesi nuk do të mbulojë zmadhimin e humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhences të të Siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese që të mos thellohen ato; **p)** Dëmet e shkaktuara nga materialet apo kafshët që transportohen me këtë mjet; **q)** Dëmet e shkaktuara nga rimorkiot që janë lidhur mjetit (aktive/pasive); **r)** Dëmet që shkaktohen kur mjeti kalon në shtigje rrugësh apo qarkullon në rrugë të paashtuara, painventarizuara (jo për qarkullim mjetesh); **s)** Dëmet e shkaktuara pjesëve të automjetit të cilat janë vendosur vetë nga i Siguruarit dhe nuk janë pjesë e katalogut të prodhimit të automjetit; **t)** Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për humbjen e mjeteve, të cilat rezultojnë të vjedhura më parë jashtë territorit të Shqipërisë; **u)** Në çdo kërkesë, padi ose procedurë tjetër gjyqësore ku Siguruesi deklaron se, sipas parashikimeve të mësipërme, humbja apo dëmtimi nuk mbulohet në sigurim, barra për të provuar që kjo humbje, shkatërrim, dëmtim apo përgjegjësi mbulohet, do t'i takojë të Siguruarit; **v)** Humbjet ose dëmtimet e mjetit motorrik të siguruar gjatë qëndrimit dhe riparimit të tij në servis; **w)** Fitimin e munguar; **x)** Dëmet që shkaktohen nga shkelja e normave të qarkullimit rrugor e klasifikuar "pakujdesi e rëndë", për të cilat Kodi Rrugor parashikon masën e heqjes së lejes së drejtimit për drejtuesin e mjetit; **y)** Mjetet me vit prodhimit më të ri se 10 vite nga data e lëshimit të Policës/kontratës së sigurimit; **z)** Mjetet për të cilat vlera e tregut/blerjes është më e madhe se 1,000,000 lekë;

Neni 5. "SHTRIRJA TERRITORIALE"

Mbulimi në sigurim është i vlefshëm vetëm

për dëmtime aksidentale të mjetit motorrik në lëvizje të siguruar me një mjet tjetër motorrik në lëvizje të ndodhura brënda territorit të Republikës së Shqipërisë;

Neni 6. "SHUMA E SIGURUAR DHE PRIMI I SIGURIMIT"

a) Mjeti motorrik i treguar në policën e sigurimit, mbulohet në sigurim për një shumë të siguruar, përcaktuar në policën e sigurimit në masën 300,000 lek dhe e cila përbën masën maksimale të dëmshpërblimit në rast ngjarje të siguruar; **b)** Shuma e siguruar mund të jetë e barabartë me vlerën e blerjes së mjetit motorrik të ri kur ky merret në sigurim në momentin e vënies në qarkullim për herë të parë, ose me vlerën e tregut në momentin e marrjes në sigurim; **c)** Pavarësisht nga vlera e mjetit në treg shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e lartë se vlera maksimale e përcaktuar në Policën e Sigurimit që është deri në masën 300,000lek; **d)** I Siguruari detyrohet t'i paguajë Siguruesit primin e sigurimit sipas shumës dhe afatit të përcaktuar në kontratë (policën e sigurimit). Primi i sigurimit është në një shumë të vetme dhe është i detyrueshëm për tu paguar me lëshimin e policës së sigurimit; **e)** Pagesa e primit të sigurimit paguhet pranë Degës ose agjencisë së Siguruesit ku është lëshuar Polica e Sigurimit. Pagesa do të quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë Bankare të Siguruesit.

Neni 7. "POLICA E SIGURIMIT"

a) Siguruesi i dorëzon të Siguruarit Policën e Sigurimit, e cila vërteton pranimin e Kushteve të Përgjithshme nga i Siguruari si dhe lidhjen e kontratës së Sigurimit; **b)** Siguruesi ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të të Siguruarit dhe të kryejë inspektime për saktësime të dhënash; **c)** Kur, Polica e Sigurimit, humbet

ose dëmtohet, në masën që bëhet e pavlefshme me kërkesën dhe shpenzimet e të Siguruarit, Siguruesi duhet të lëshojë një dubllkatë të saj; **d)** Kjo policë Sigurimi e ka vlefshmërinë vetëm për një ngjarje sigurimi. Kjo kontratë është e vlefshme vetëm për një rast sigurimi të ndodhur gjatë periudhës së mbulimit në sigurim të ndarë sipas çdo riziku të vecantë të përcaktuar në policën e sigurimit; **e)** Kalimi i të Drejtave të drejtat dhe detyrimet e të Siguruarit në këtë Kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Ky miratim do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në Kontratën e Sigurimit.

Neni 8. "PERIUDHA E SIGURIMIT"

a) Kjo kontratë, vlen për dëmin që ndodh gjatë periudhës së treguar në policën e sigurimit. Periudha e sigurimit është një vjeçare; **b)** Mbulimi në sigurim, fillon në orën 24.00 të ditës të lëshimit të policës të sigurimit dhe përfundon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë mbarimi në policën e sigurimit me kusht që të jetë paguar më parë primi i sigurimit, në të kundërt në rast se nuk është paguar primi i sigurimit kontrata e sigurimit nuk hyn në fuqi dhe nuk krijon efekte juridike për palët.

Neni 9. ZGJIDHJA DHE PËRFUNDIMI I POLICËS SË SIGURIMIT"

Kontrata e Sigurimit është e pavlefshme, ose/dhe Siguruesi do të zgjidhë Kontratën e Sigurimit në qoftë se: **a)** Nëse vërtetohet se, rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar ose ka pushuar së qeni para lidhjes së kontratës. **b)** Nuk është paguar primi i plotë i sigurimit; **c)** Ka të dhëna për pasaktësi të informacionit të dhënë nga i Siguruari; I Siguruari mund ta zgjidhë Kontratën: Duke njoftuar 30 ditë përpara datën e zgjidhjes; **d)** Me shqyrtimin e kërkesës për dëmshpërblim, të paraqitur nga i siguruari; **e)** Me pushimin e interesit

pasuror të siguruarit mbi mjetin (përfshirë ndryshimin e pronësisë);

Neni 10. "DETYRIME "

a) I Siguruari duhet të informojë me shkrim Siguruesin për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut; **b)** I Siguruari pas lidhjes së Kontratës së Sigurimit, duhet të njoftojë me shkrim çdo ndryshim në mjetin motorrik që sjell pasojë rritjen e rrezikut. Siguruesi ka të drejtë, nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit, ose të zgjidhë Kontratën. Mosnjoftimi nga i Siguruari, sjell si pasojë clirimin e Siguruesit nga detyrimi për pagesën e dëmshpërblimit; **c)** I Siguruari duhet të marrë hapa të arsyeshëm për të mbrojtur nga dëmtimet apo humbjet mjetin motorrik, duke e mbajtur në kushte të sigurta dhe eficiente; **d)** Nëse i Siguruari kryen një tjetër sigurim (dysigurim) për mbulimin e rreziqeve apo humbjet me këto Kushte të Përgjithshme, ai duhet t'i njoftojë Siguruesit të parë emrin e Siguruesit tjetër si dhe shumën e siguruar. Në rast se, qëllimisht apo për neglizhencës i Siguruari nuk plotëson detyrimet sipas paragrafit të mësipërm, Siguruesi ka të drejtë të zgjidhë policën e sigurimit dhe të mos kthejë primin; **e)** Në rastin e Dysigurimit, masa e dëmshpërblimit nga të dy kontratat, nuk mund të jetë më e madhe se vlera e humbjes duke zbritur pjesën e zbritshme. Nëse i siguruari kryen sigurime të tjera me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit; **f)** Në rast dëmi, Siguruesi lirohet nga detyrimi për dhënie dëmshpërblimi kur shkak i dëmit është një rrethanë që nuk i ishte bërë e njohur Siguruesit nga i Siguruari kur ky i fundit kishte apo duhej të kishte dijeni për rrethanën në fjalë dhe rrethana është e një rëndësie të

tillë që ndikon në dhënien ose jo të dëmshpërblimit; **g)** Siguruesi dhe i Siguruari, mund të bien dakord për sigurimin e mjetit motorrik për një shumë sigurimi më të vogël se vlera e tregut apo blerjes së mjetit motorrik të ri. Në këtë rast, dëmshpërblimi që do të përfitojë i Siguruari, do të llogaritet duke shumëzuar vlerën e dëmit me koeficientin e nënsigurimit. Koeficienti i nënsigurimit, është raport i shumës së siguruar kundrejt vlerës së tregut apo të blerjes së mjetit motorrik të ri; **h)** Nënsigurimi, do të zbatohet, edhe nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, shuma e siguruar, është më e ulët se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorrik të ri; **i)** Nëse, Shuma e Siguruar, është përcaktuar më lartë se vlera e tregut apo vleres se blerjes së të njëjtit mjet motorrik të ri, Siguruesi dhe i Siguruari veçmas ose bashkarisht, duhet të bëjnë ndryshimet përkatëse në Policën e Sigurimit, duke zvogëluar si Shumën e Siguruar ashtu dhe Primin e Sigurimit; **j)** Në çdo rast, kufiri i përgjegjësisë së Siguruesit, nuk do të jetë më i lartë se vlera e vendosur në Policën e Sigurimit deri në 300,000lek, duke zbritur pjesën e zbritshme e cila do mbulohet nga vetë i siguruari. **k)** Nëse, i Siguruari, lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi, ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit;

Neni 11. "PJESA E ZBRITSHME"

Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe (ose) franshizë. Masa e pjesës së zbritshme dhe franshizës, vendosen në policën e sigurimit; **a)** Për çdo rast dëmi Siguruesi, do të zbresë nga shpërblimi i llogaritur, Pjesën e Zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit në shumë absolute apo përqindje dhe e cila është ajo pjesë e dëmit që përballohet nga

klienti; **b)** Pjesa e zbritshme në cdo rast e aplikuar është 10% e vlerës së dëmit ose shumës së siguruar (vlerë e maksimale e dëmshpërblimit 300,000lek).

Neni 12. NJOFTIMI I RASTIT TE SIGURIMIT DHE DËMHPËRBLIMI NGA PËRPLASJA E VETË MJETIT MOTORRIK, TË PËRGJITHSME."

12.1 Është kusht parësor për përgjegjësinë e Siguruesit, që për çdo ngjarje që mund të jetë shkak për kërkesë për dëmshpërblim, i **Siguruari, menjëherë duhet: a)** Të njoftojë Siguruesin për rastin e sigurimit brenda një periudhe prej 24 orësh nga moment i ndodhjes së tij. Nëse i Siguruari nuk bën njoftimin si më sipër, Siguruesi ka të drejtë të mos paguajë dëmshpërblimin; **b)** Në rastin e ndodhjes së aksidentit, i Siguruari detyrohet menjëherë të njoftojë sipas rastit të sigurimit, Policinë Rrugore, të Rendit, Zjarrfikësat dhe të vërë në dispozicion të Siguruesit, vërtetimin e autoriteteve të lartpërmendura, lidhur me njoftimin e bërë; **c)** Të plotësojë formularin **"Vërtetim Miqësor i Ngjarjes", "Njoftim i Rastit të Sigurimit"** dhe t'ja paraqesë atë Siguruesit, të shoqëruar me të gjitha të dhënat identifikuese përkatëse të mjetit motorrik, të dëmtuar apo humbur, si dhe rrethanat përkatëse të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit; **d)** Të shmangë dhe minimizojë humbjet ose dëmtimet aq sa është e mundur; **e)** T'i paraqesë siguruesit raportin e organeve të policisë rrugore mbi aksidentin e ndodhur; **f)** Të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim pranë Siguruesit brenda afateve të parashikuara nga Kodi Civil, vetëm pasi ka bërë njoftimin e rastit të sigurimit nëpërmjet formularit standart sipas Nenit 12.1 pika **(b)** dhe **(c)** të Kushteve të Përgjithshme;

12.2 Siguruesi gëzon të drejtën të çlirohet nga detyrimet e tij për dëmshpërblim nëse: **a)** I Siguruari, me qëllim apo për neglizhencë nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht

detyrimet e tij; **b)** I Siguruari, përpiqet të paraqesë në mënyrë të shtrëmbër ose mashtruese faktet para Siguruesit të cilat kanë rendësi për mundësinë dhe/ose masën e dëmshpërblimit;

12.3 Siguruesi ka të drejtë të verifikojë rrethanat në të cilat ka ndodhur Rasti i Sigurimit, si edhe të kryejë ekspertizën e dëmit apo të humbjeve në mjetin motorrik të siguruar brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit të ngjarjes së sigurimit. Gjatë kësaj periudhe, i Siguruari është i detyruar të mbajë mjetin motorrik të dëmtuar në dispozicion të Siguruesit, pa e riparuar atë. Siguruesi do të paguajë për dëmet në mjetin motorrik të siguruar, deri në limitin e përgjegjësisë, duke zbritur pjesën e zbritëshme të përcaktuar në Kontratën e Sigurimit.

12.4 Siguruesi për dëmtime material përcakton formë dëmshpërblimi:

a) Riparimi i mjetit të dëmtuar, ofruar nga Siguruesi, në rastin e xhamave të mjetit do ofrohet vetëm pranë servisit Massglass, ndërsa për fenerë apo stopa do ofrohen nga Albsig Sh.a. sipas detyrimit për kthimin në gjëndje të mëparshme të mjetit;

12.5 Siguruesi mund të shtyjë kohën e pagesës: **a)** Për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguruarit, për të marrë pagesën; **b)** Në qoftë se, janë filluar hetime penale, në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Siguruarit; **c)** Për aq kohë sa, i Siguruari, nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi;

12.6 Në rastin e dëmit material të pjesshëm, dëmshpërblimi do të jetë i barabartë me shpenzimet e riparimit minus pjesën e zbritshme sipas përcaktimit në policën e sigurimit;

12.7 Siguruesi nuk do të dëmshpërblej dëme vlera e të cilave është më e vogël se pjesa e zbritshme fikse;

12.8 Në rast pagesë dëmshpërblimi, sipas kësaj kontrate, Siguruesi ALBSIG sh.a

nëpërmjet kësaj kontrate në bazë dhe të nenit 1142 të Kodit Civil i kalon e drejta për të kërkuar kthimin e shumës të paguar ndaj çdo personi ose organizate që është përgjegjës për shkaktimin e dëmit. I Siguruari, do të veprojë, me të gjitha mënyrat e duhura për të siguruar këto të drejta dhe nuk do të bëjë asnjë veprim për të paragjykuar këto të drejta;

12.9 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Vnedit, ku ka qëndren e padituri apo ku është shkaktuar dëmi. Palet në rast konflikti angazhohen ta zgjidhin ceshtjen nëpërmjet institutit të ndërmjetësimit;

12.10 Korrespondenca midis Siguruesit dhe të Siguarit do të zhvillohet me letër ose letër rekomande;

Neni 13. "MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE"

I siguruari është njohur me deklaratën e privatesise të shoqërisë së sigurimeve dhe autorizon ALBSIG sh.a që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal, i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale") si dhe transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale.

Në çdo rast, mbrojtja e të dhënave personale do të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 14. "E DREJTA E INFORMIMIT"

14.1 I siguruari ka të drejtën të informohet nga Siguruesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose përfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nëpërmjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare në internet apo broshurave informative të përdorura nga shoqëria.

14.2 I siguruari është informuar nga Siguruesi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të dhënat juridike të siguruesit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe mënyra e pagesës së primit, metodën e llogaritjes së vlerës së kompensueshme dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me kontratën e sigurimit.

Neni 15. "E DREJTA E TË SIGURUARIT PËR TU ANKUAR"

I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kanë të drejtë të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, në rast se çmojnë se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit. Ankesa mund të paraqitet në formë elektronike (e-mail) ose me shkrim në adresën postare të shoqërisë. Shoqëria e sigurimit do t'i pergjigjet çdo ankese të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do të jap çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda afateve të përcaktuara në ligj. Kjo kontratë siguri hartohet dhe zbatohet në përputhje me kushtet e përcaktuara si më sipër, Kodin Civil, Ligjin nr.52 të vitit 2014 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve".



ALBSIG

Neni 16. "ZGJIDHJA E MOSMARREVËSHJEVE"

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve zgjidhet me mirëkuptin, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata e Rrethit Gjyqësor të vendit, ku ka qendrën e padituri apo ku është shkaktuar dëmi. Palet në rast konflikti angazhohen ta zgjidhin çështjen nëpërmjet institutit të ndërmjetësimit. Për gjithcka jo të parashikuar në këto kushte, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni tjetër në fuqi.

